# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-470919**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Arrestohet i 'forti' i Shkodrës Bledar Cafi, në kërkim Indrit Dokle |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394239.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 08:53:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 08:43:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 08:42:00 UTC → 26 shtator 2026, 08:44:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8c0f7288671e51dad84042db103fa8ef7f2935655d9a4c3b3737b194d07a3b82` |
| TEKSTI | `8bce05f38c7029e5a0ce8383977b9f0b59f6b530f87122c3e3f810ecff44a010` |
| PAMJA | `b32e8b51146802e2e2b85a31ea2d1df75a3fa61718a3942012f90f85ec3825a6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `30216a0c532cfdf9f34c6ab16b681ab5603efca44447dd00d86fdb66bf3ccaf3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aeeabf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/30216a0c532cfdf9f34c6ab16b681ab5603efca44447dd00d86fdb66bf3ccaf3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Arrestohet i ‘forti’ i Shkodrës Bledar Cafi, në kërkim Indrit Dokle

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 26.09.2026, 10:43

Share Share



Bledar Cafi, 50 vjeç, është arrestuar në Shkodër gjatë operacionit të koduar “Muri i Lartë”, të zhvilluar nga Policia e Shtetit, BKH-ja dhe strukturat e tjera operacionale, nën drejtimin e SPAK. Cafi u kap në banesën e tij në orët e para të mëngjesit, ndërsa GJKKO, me vendim të datës 25 shtator 2026, kishte caktuar ndaj tij masën e sigurisë “arrest me burg” për veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, si dhe akuza të tjera që lidhen me veprimtarinë e grupit.

Në kuadër të operacionit, autoritetet kanë ekzekutuar edhe kontrolle për lokalizimin e Indrit Dokles, 43 vjeç, i njohur edhe me aliasin I. D., lindur në Kukës dhe banues në Tiranë. Sipas Policisë së Shtetit, ai është person në kërkim që prej vitit 2024 dhe ndaj tij GJKKO ka caktuar gjithashtu masën “arrest me burg” për trafikim të lëndëve narkotike në bashkëpunim dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal. Gjatë kontrolleve në ambientet që i përkasin tij, Dokle nuk është gjetur.

Operacioni është zhvilluar me përfshirjen e Forcave Speciale RENEA, Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtorisë për Hetimin e Narkotikëve, Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe BKH-së, në zbatim të urdhrit të SPAK dhe vendimit të gjykatës. Policia e Shtetit e cilëson Bledar Cafin si person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, ndërsa vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e Indrit Dokles. Hetimet për aktivitetin e dyshuar kriminal vijojnë nën drejtimin e SPAK.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.